

RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË KOMUNAVE

Ky raport pasqyron funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës.

Këtu janë përfshirë në mënyrë të përmbledhur aktivitetet e komunave dhe trupave ndihmëse të tyre, për periudhën janar - qershor 2019

*Janar – Qershor,
2019*



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË
KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
JANAR-QERSHOR 2019

PËRMBAJTJA:

<i>Qëllimi i raportit</i>	<i>4</i>
<i>Përmbledhje ekzekutive</i>	<i>5</i>
<i>1. Funksionimi i kuvendeve të komunave.....</i>	<i>6</i>
<i>2. Komitetet e përhershme të kuvendeve të komunave.....</i>	<i>8</i>
<i>3. Komitetet e tjera të kuvendit të komunës.....</i>	<i>9</i>
<i>4. Komitetet konsultative të kuvendit të komunës.....</i>	<i>10</i>
<i>5. Takimet publike me qytetarët.....</i>	<i>11</i>
<i>6. Raportimi i kryetarit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës.....</i>	<i>12</i>
<i>7. Aktet e kuvendeve të komunave.....</i>	<i>13</i>
<i>7.1 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve.....</i>	<i>13</i>
<i>7.2 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.....</i>	<i>14</i>
<i>7.3 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga Ministrit e linjës.....</i>	<i>15</i>
<i>8. Këshilli Komunal për Siguri Në Bashkësi.....</i>	<i>16</i>
<i>8.1 Temat e trajtuara lidhur me sigurinë në bashkësi.....</i>	<i>17</i>
<i>8.2 Sfidat lidhur me sigurinë në bashkësi.....</i>	<i>17</i>
<i>Rekomandimet.....</i>	<i>18</i>

QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve qendrore, komunave, qytetarëve, organizatave joqeveritare dhe grupeve tjetër të interesit, për funksionimin e komunave konform mandatit të përcaktuar ligjor.

Përmes këtij raporti mundohemi të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e organeve të komunave. Gjithashtu, raporti shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e organeve të komunave.

Në këtë raport janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punëve dhe aktiviteteve të organeve të komunave, për periudhën janar-qershor 2019. Po ashtu, janë përfshirë gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 38 komuna të Republikës së Kosovës. Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe organet e komunave të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Funksionimi i Kuvendeve të Komunave, Në Republikën e Kosovës në këtë periudhë kanë funksionuar kuvendet e 38 komunave, të cilat kanë mbajtur mbledhje rregullisht dhe sipas raporteve të monitorimit, mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun. Gjatë kësaj periudhe, kuvendet e komunave kanë mbajtur 275 mbledhje. Prej tyre 218 kanë qenë të rregullta, 21 të jashtëzakonshme, 35 solemne dhe 1 urgjente.

Komitetet e Përherëshme, Sa i përket Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, ato janë themeluar në të gjitha komunat dhe janë funksionale. Sipas të dhënave, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 224 takime, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 176 takime.

Takimet Publike me Qytetarët, Gjatë kësaj periudhe në komunat e Republikës së Kosovës janë mbajtur gjithsej 26 takime publike me qytetarët në 26 komuna. Në 12 komuna nuk janë mbajtur takim publike me qytetarët, si: **Prizren, Deçan, Junik, Mamushë, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Lipjan, Klinë.**

Raportimi i Kryetarit të Komunës, Lidhur me obligimin e kryetarëve të komunave për të paraqitur raport para anëtarëve të Kuvendit të Komunës për gjendjen ekonomiko-financiare gjatë kësaj periudhe ka pasur raportime në 34 komuna, ndërsa kryetarët nuk kanë raportuar para Kuvendit të Komunës në 4 komuna, si: **Prishtinë, Novobërdë, Glllogoc, Kllokot.**

Aktet e Kuvendeve të Komunave, Gjatë kësaj periudhe kuvendet e komunave kanë miratuar 1100 akte, (63 rregullore, 1037 vendime). Nga gjithsej 1100 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 466 akteve, prej te cilave, 451 akte janë konfirmuar të ligjshme, ndërsa 15 të kundërligjshme. MAPL, ka dërguar në Ministritë e linjës për shqyrtim të ligjshmërisë 634 akte, prej te cilave 580 akte janë konfirmuar të ligjshme ndërsa 54 akte janë konstatuara të kundërligjshme.

1. FUNKSIONIMI I KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Mbledhjet e kuvendeve të komunave

Kuvendi i Komunës sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, është organi më i lartë i komunës. Kuvendi është organ vendimmarrës i komunës, i cili funksionon në bazë të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës. Kuvendi duhet të mbaj së paku 10 mbledhjeve në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit. Ky është kriteri minimal i specifikuar, i cili kërkohet të respektohet, ndërsa komunave u është lënë mundësia të përshtatin numrin e mbledhjeve varësisht nga nevojat.


Gjatë periudhës janar-qershor 2019, në Republikën e Kosovës kanë funksionuar kuvendet e 38 komunave. Mbledhjet janë mbajtur rregullisht dhe sipas raporteve të monitorimit, mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun. Më qëllim të mbikëqyrjes së punës së kuvendeve të komunave, MAPL, ka bërë monitorimin e mbledhjeve të kuvendeve përmes sistemit të teleprezencës, kurse me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në komunat Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Probleme me funksionalizimin e teleprezencës gjatë kësaj periudhe kanë pasur komunat: Mamushë dhe Junik. Sa i përket mbarëvajtjes së mbledhjeve të kuvendeve dhe funksionimit të tyre, komunat në masën më të madhe kanë respektuar legjislacionin e aplikueshme të Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur 275 mbledhje. Prej tyre 218 kanë qenë të rregullta, 21 kanë qenë të jashtëzakonshme, 35 kanë qenë solemne dhe 1 urgjente. Në vijim përmes grafikunit kemi paraqitur numrin e mbledhjeve të kuvendeve të komunave:

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave:

- Te rregullta 218
- Te jashtëzakonshme 21
- Solemne 35
- Urgjente 1



Grafikoni 1: Mbledhjet e kuvendeve të komunave.


Siç shihet, të gjitha komunat kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e se paku 5 mbledhjeve në gjashtë mujorin e parë të vitit, ashtu siç e përcakton Ligji për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht neni 43.2.

Lidhur me njoftimin për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe raportuese, komunat kanë kryer obligimin ligjor në raport me MAPL-në si dhe me publikun, duke informuar në vazhdimësi për mbajtjen e mbledhjeve, sipas afatit të përcaktuar ligjor.

Mbarëvajtja e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, gjatë kësaj periudhe në përgjithësi ka qene konform dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, mirëpo janë evidentuar disa raste kur një pjese e anëtarëve të kuvendeve në disa komuna kanë lëshuar mbledhjet për arsye të ndryshme.

2. KOMITETET E PËRHERSHME TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Kuvendi i Komunës ka nevojë për trupa ndihmëse me qëllim të shqyrtimit të hollësishëm të politikave strategjike komunale, akteve të tjera si rregullore, vendime dhe plane, nga njëra anë, si dhe me qëllim të mbikëqyrjes së veprimtarisë organit ekzekutive, në anën tjetër. Për Prandaj, Kuvendi i Komunës themelon komitete të përhershme të cilat e ndihmojnë atë në përmbushjen e këtyre obligimeve dhe ushtrimin e këtyre kompetencave. Numri i takimeve të komiteteve të obligueshme është paraqitur në vijim:



Grafikoni 2: Takimet e komiteteve të përhershme.

Në total, Komiteti për Politikë dhe Financa kanë mbajtur 224 takime, kurse Komiteti për Komunitete 176 takime. Komiteti për Politikë dhe Financa konsiderohet si trup kryesor këshillëdhënës i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës.

Kështu, Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizës vjetore buxhetore afatmesme, planit vjetor të prokurimit, rregullores vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planit vjetor të punës për auditimin e brendshëm, planit buxhetor vjetor, afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin komunal.

Ndërsa, Komiteti për Komunitete, është komiteti i dytë i përhershëm i Kuvendit të Komunës, detyrë e të cilit është shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim, shqyrtimi i politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve. I rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

3. KOMITETET E TJERA TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Si mundësi për të ndihmuar organet e komunës në ushtrimin e kompetencave në një fushë të caktuar, Kuvendi i Komunës mund të themeloj komitete të tjera të cilat do të ndihmojnë atë dhe ekzekutivin në punën e tyre. Këto komitete të veçanta mund të themelohen për sektor specifik si arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Në vijim në formë tabelore kemi paraqitur numrin e komiteteve të tjera në komuna:

Komunat	Shëndetësi dhe mirëqenie sociale	Arsim Kulturë rini dhe Sport	Planifikim Hapësiror	Ndërmjetësim	Zhvillim Ekonomik	Bujqësia dhe Ujëra	Shërbime Publike	Pronë	Mbrojtje dhe shpëtim	Kategoritë e Dala nga Lufta	Persona me aftësi të kufizuar	Barazi Gjinore
<i>Klina</i>	1	1	1				1	1				
<i>Fushë Kosovë</i>	1	1	1	1	1	1			1			
<i>Vitia</i>	1	1	1				1					1
<i>Skenderaj</i>									1			
<i>Prishtina</i>		1	1		1		1	1	1			
<i>Gjilan</i>	1	1	1		1				1			1
<i>Podujeva</i>	1											
<i>Mitrovicë Jugore</i>	1	1	1		1		1					1
<i>Ferizaj</i>					1					1	1	1
<i>Shtime</i>	1	1										
<i>Malisheva</i>	1	1	1		1		1					1
<i>Kaçaniku</i>							1					
<i>Istog</i>	1	1	1				1	1				
<i>Graçanicë</i>							1					
Total	9	9	8	1	6	6	8	3	4	1	1	5

Tabela 1: Komitetet e tjera të themeluara në komuna.

Siç shohim nga grafiku dhe tabela më sipërme, në komuna janë themeluar komitete të tjera në fushat e paraqitura si më lartë. Prej tyre më së shumti i është kushtuar rëndësi Komitetit për Shëndetësi, Arsim dhe në fushën e urbanizmit. Megjithatë, në pak raste është vërejtur se këto komitete shqyrtojnë politika të natyrës për të cilën janë themeluar, ngase rolin kryesor e kryejnë komitetet e përhershme. Pengesë është parë edhe mungesa e kompensimit të punës së këtyre komiteteve që ka ndikuar në uljen e ritmit të punës së tyre.

4. KOMITETET KONSULTATIVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Kuvendi i Komunës, duke u bazuar në nenin 73, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimin Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna, është i obliguar të themelojë edhe komitetet konsultative sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Te komitetet konsultative, komunat janë përqendruar më tepër në fushën e zhvillimit ekonomik, arsimin, kulturën, rininë, sportin dhe shërbimeve publike.

Në vijim, përmes tabelës kemi paraqitur komunat të cilat kanë themeluar komitete konsultative, si fushave përkatëse:

Komitetet Konsultative	Planifikim hapësor	Arsim, Kulturë Rini dhe Sport	Zhvillim ekonomik	Urbanizëm	Shëndetësi dhe mirëqenie sociale	Shërbime publike	Personat me aftësi të kufizuara	Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimarrje	Mbrojtje të mjedisit	Të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore	Bujqësi, zhvillim rural dhe mbrojtje të	Çështje emergjente
Skenderaj		1	1							1		
Vushtrri	1			1		1	1		1	1		
Gjakova		1	1				1					
Gjilani	1						1					
Vitia							1	1				
Skenderaj		1	1		1					1		
Kamenicë		1			1	1	1					
Kaçaniku							1					
Mitrovicë Jugore		1			1	1						
Deçani							1					
Juniku							1					
Istog											1	1
Peja			1				1		1			
Total	1	5	4	1	3	3	9	1	2	3	1	1

Tabela 2: Numri i komiteteve konsultative në komuna.


Siç vërejmë nga figura e mësipërme, në komuna janë themeluar komitete konsultative, në fushën e planifikimit hapësor në fushën e arsimit komunat, në fushën zhvillimit ekonomik , në fushën e urbanizmit në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në fushën e shërbimeve publike.

5. TAKIMET PUBLIKE ME QYTETARËT

Komunat si njësi vetëqeverisëse lokale duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale neni 68, janë të obliguara të vënë në funksion takimet publike, si parime bazë të komunikimit drejtpërdrejtë me qytetarë, ku secili person apo organizatë me interes ka të drejtë të marr pjesë. Kuvendi i Komunës përmes njësisë/zyrtarit për komunikim me qytetarë njofton qytetarët e komunës së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit ku njoftimi përmban datën, kohën, vendin e mbajtjes së takimit dhe rendin e ditës.

Komunat gjatë kësaj periudhe janë kujdesur të respektojnë rregullat për njoftimin e qytetarëve me rastin e diskutimeve publike. Për më tepër, ueb-faqet zyrtare të komunave në vazhdimësi kanë qenë transparente duke njoftuar me kohë lidhur me aktivitetet e komunave për takimet publike.

Të dhënat e paraqitura në diagram tregojnë numrin e takimeve të organizuara me qytetarë për periudhën raportuese janar-qershor 2019:




Grafikoni 3: Numeri i takimeve publike me qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe në komunat e Republikës së Kosovës janë mbajtur gjithsejtë 26 takime publike me qytetarët në 26 komuna. Komunat të cilat nuk kanë mbajtur asnjë takim publik me qytetarët brenda kësaj periudhe raportuese, janë komunat: **Leposaviq, Mitrovicë veriore, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Mamushë, Junik, Deçan, Prizren, Klinë, Lipjan dhe Fushë Kosovë.**

6. RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS PËR SITUATËN EKONOMIKO-FINANCIARE TË KOMUNËS

Përveç përgjegjësiave të tjera të kryetarit të komunës sipas Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 58, paragrafi j), kryetari i komunës është i obliguar të raportojë para kuvendit të komunës së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës. Në vijim në formë tabelore po i paraqesim numrin e raportimeve të Kryetarit gjatë kësaj periudhe:



Grafikoni 4: Raportimi i kryetarëve të komunave.


Gjatë kësaj periudhe Janar-Qershor 2019, kanë raportuar gjithsej 34 kryetarë të komunave, para Kuvendit Komunal, sa i përket situatës ekonomike-financiare të komunës. Ndërsa në 4 komuna, kryetarët nuk kanë raportuar asnjëherë, (Glogoc, Prishtinë, Novobërdë, Klokot).

Ne disa komuna, (Kaçanik, Prizren, Deçan, Suharekë), kryetarët e komunave kanë raportuar më shumë se 1 here, lidhur me situatën ekonomiko financiare, përfshirë, raportin financiar për vitin 2018 si dhe raportin e 3 mujorit të parë të vitit 2019

7. AKTET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Kompetencë dhe funksion themelor i Kuvendit të Komunës, ndër të tjera është miratimi i rregulloreve, vendimeve, planeve dhe akteve të tjera të nevojshme për zbatimin e legjislacionit sektorial që prek kompetencat e komunave.

Komunat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore, që rregullojnë fusha të ndryshme të marrëdhënieve juridike, mirëpo më kryesoret janë: miratimi i akteve nga fusha e mjedisit, akteve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, akteve për emërtimin e rrugëve, sferës së shërbimeve publike etj. Ne vijim, përmes grafikonit kemi paraqitur numrin e akteve të miratuara nga kuvendet e komunave.



Grafikoni 5: Numeri i akteve të miratuara nga kuvendet e komunave.

7.1 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve


MAPL është autoriteti mbikëqyrës i ligjshmërisë së akteve të komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Ndërsa, shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar kompetencat. Me qëllim të lehtësimit të mbikëqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale është miratuar Rregullorja (QRK) NR-01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në përgjithësi ka qenë i rregullt, dërgimi i akteve të kuvendeve të komunave është bërë në afatin e përcaktuar ligjor brenda 7 dite nga miratimi i akteve në kuvendin e komunës.

Gjatë kësaj periudhe, janar-qershor 2019, kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 1100 akte, prej të cilave 63 rregullore dhe 1037 vendime. Nga gjithsej 1100

akte te miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 466 akte, ku 451 akte janë konfirmuar të ligjshme, ndërsa 15 akte janë konstatuar të kundërligjshme. Ndërsa, 634 akte janë dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë në ministrinë e linjës (MMPH, MASHT, MF, MKRS, MZHE, MI), konform mandatit të tyre të përcaktuar ligjor.

7.1.1 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal



Grafikoni 6: Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga MAPL.


Siç shihet edhe nga grafikoni i mësipërm, nga gjithsej 466 akte të shqyrtuara nga MAPL, 451 janë konfirmuar si të ligjshme, ndërsa, 15 akte janë konstatuar të kundërligjshme.

Për gjitha shkeljet e konstatuara, MAPL, ka dërguar kërkesat për rishqyrtim në organet e komunave. Pas pranimit të kërkesave për rishqyrtim, komunat kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 11 akte, konform kërkesës së MAPL-së, ndërsa 4 akte nuk janë rishqyrtuar ende.

Nga 4 akte sa nuk janë rishqyrtuar, MAPL, 3 akte i ka përcjellë në MD për kundërshtimin e tyre në gjykatë, ndërsa 1 akt është brenda afatit ligjor për rishqyrtim.

Aktet e komunave që janë kthyer në rishqyrtim nga MAPL, dominojnë ato të cilat kanë të bëjnë me dhënie të pronës komunale në shfrytëzim, për ndërtimin e objekteve fetare, rregullores së punës së kuvendit, marrëveshjeve të bashkëpunimit ndër komunal ndërkombëtar, caktim të lokacioneve për mbeturina, miratimin e planeve për transparencë komunale, njohjen e të drejtës për regjistrimin e pronës komunale etj.

7.1.2 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga Ministrit e linjës



Grafikoni 7: Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga ministrit e linjës.

Siç shihet edhe nga grafikoni i mësipërm, nga gjithsej 634 akte të shqyrtuara nga ministrit e linjës, 580 janë konfirmuar si të ligjshme, ndërsa, 54 akte janë konstatuar të kundërligjshme. Për gjitha shkeljet e konstatuara, ministrit e linjës, përmes MAPL-së, kanë dërguar kërkesat për rishqyrtim në organet e komunave. Pas pranimit të kërkesave për rishqyrtim, komunat kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 37 akte, konform kërkesës së ministrive të linjës dhe MAPL-së, ndërsa 17 akte nuk janë rishqyrtuar ende. Nga 17 akte sa nuk janë rishqyrtuar, MAPL, 13 akte i ka përcjellë në MD për kundërshtimin e tyre në gjykatë, ndërsa 4 akte janë brenda afatit ligjor për rishqyrtim.


Aktet e kthyera nga ministritë e linjës kanë të bëjnë më hartimin e planeve zhvillimore komunale, pastaj miratimin e hartave zonale, miratimin e rregulloreve për tatimin në pronë, pagesën e komisioneve të cilat krijohen nga kuvendi i komunës, akteve për mbrojtjen e vlerës së natyrës, për caktim të lokacioneve për ndërtim të xhamive, rregulloreve për taksa tarifa dhe ngarkesa komunale, akteve që kanë karakter të bashkëfinancimit të ndërtimit të shtëpive të banimit etj.

8 KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Në nivelin lokal, trupa me rëndësi për sigurinë publike të qytetarëve por edhe më gjerë janë Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB). Themelimi i KKSB-së bazën ligjore e ka me Ligjin për Policinë, ndërsa përbërja, mënyra e funksionimit dhe obligimet tjera fillimisht janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL.

Me ndryshimet e bëra me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, është definuar edhe më qartë pozicioni i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në raport me komunën. Edhe me këto ndryshime normative është përcaktuar roli preventiv i këtij Këshilli ndaj dukurive negative në shoqëri dhe janë përcaktuar një numër i objektivave me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për natyrën e krimeve, parregullsive dhe sjelljeve të dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave të qytetarëve dhe përfaqësimit të pikëpamjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve për çështjet e krimit.

Me udhëzimin administrativ për KKSB, ndër të tjera është rregulluar edhe numri minimal prej gjashtë takimeve në vit, tri prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë. Për numrin e takimeve, është paraqitur grafikoni në vijim:



Grafikoni 8: Takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Për nga numri i takimeve, më aktiv ka qenë Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Klokotit dhe Hanit të Elezit me nga 6 (gjashtë) takime të mbajtura, pasuar nga Komuna e Vitisë dhe Rahovecit me 4 takime.

Në 15 komuna, (Kaçanik, Gllogoc, Prizren, Dragash, Istog, Pejë, Vushtrri, Podujevë, Prishtinë, Ferizaj, Shtërpçë, Mitrovicë Jugore, Obiliq, Suharekë, Gjilani) KKSB-ja kanë mbajtur nga 3 (tre) takime që është obligim ligjor për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit.

Në 7 komuna (Ranillug, Kamenicë, Graçanicë, Deçani, Junik, Malishevë, Shtime) KKSB-të kanë mbajtur nga 2 takime, ndërsa nga 1 takim kanë mbajtur KKSB-të në 8 komuna, (Partesh, Novobërdë, Skenderaj, Gjakovë, Klinë, Obiliq, Fushë Kosovë, Mamushë). Komuna e Lipjanit ka të themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) por për periudhën e raportimit nuk ka mbajtur asnjë takim.

Ndërsa, komunat (Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok) nuk e kanë të themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

8.1 Temat e trajtuara lidhur me sigurinë në bashkësi

Problemet më të shpeshta të cilat janë trajtuar gjatë kësaj periudhe të raportimit si dhe iniciativat për realizimin e projekteve për siguri në bashkësi gjatë vitit 2019, ku janë të planifikuara edhe projekte të cilat kanë dalë si rekomandime të KKSB-së, janë:

- Sensibilizimi dhe inicimi i aktiviteteve për parandalimin e qitjes me armë zjarri në ahengje dhe manifestime publike;
- Kastrimi i qenve endacak;
- Vendosja e kamerave në qytet dhe në shkolla apo afër shkollave;
- Ndriçimi publik;
- Pastrimi i hapësirave publike nga bora;
- Hartimi i planit operativ në koordinim me Policinë e Kosovës për parandalimin e zjarrëvëniës;
- Iniciativa për vendosjen e shenjave të komunikacionit;
- Rregullimi dhe vënia në funksion e sistemit të alarmit publik të banorëve të komunës;
- Kontrollimi i zonave të dyshimta për mjete shpërthyes;
- Asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i trotuareve, kanalizimeve etj;
- Menaxhimi i mbeturinave;
- Adaptimi i kushteve për të kthyerit.

8.3 Sfidat

Sfidat më të shpeshta me të cilat ballafaqohet Këshilli Komuna në Siguri në Bashkësi janë:

- Gjetja e fondeve për realizimin e projekteve të propozuara nga KKSB-të;
- Pagesa e anëtarëve të KKSB-së;
- Ndotja e Ambientit;
- Vendosja e nënkalimeve në rrugët kryesore sidomos afër shkollave;
- Siguria në trafik.

Rekomandimet:

- Rishqyrtimi i akteve nga komuna e Prishtinës, Gjakovës, Gllogocit, Prizrenit, Mamushës dhe Skenderajt ashtu siç përcaktohet në nenin 80.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
- Themelimi dhe funksionalizimi i KKSBB-ve në komunat: Mitrovicën e Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan konform Ligji Nr. 04/L-076 Për Policinë dhe Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL;
- Dërgimi i materialeve të mbledhjes nga organet e komunës së Gjakovës organit mbikëqyrës (MAPL-së) për mbledhjet e rregullta shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së kuvendit dhe për mbledhje të jashtëzakonshme tri ditë (3) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të Komunës ashtu si është e përcaktuar në nenin 43. pika 3 dhe 44 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimit (MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,;
- Njoftimi për mbajtjen e takimeve të KKSBB-ës dhe dërgimi i procesverbaleve nga komuna e Prishtinës, Gllogocit, Skenderajt, Deçan, Junik, Mamushë, Prizren, Suharekës, Gjakovës, Obiliqit, Dragashit ashtu si e përcakton Ligji Nr. 04/L-076 Për Policinë dhe Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL,
- Dërgimi i listën se akteve të miratuara nga Kryetari i Komunës së Gjakovës, Prizrenit, Deçanit, Junikut, Mamushës, Shtërpçë dhe Ranillug ashtu si është e përcaktuar në nenin 80.1 të LVL-së;
- Mbajtja e takimeve publike konform nenit 68.1 të Ligjit, Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale nga komuna: Leposaviq, Mitrovicë veriore, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Mamushë, Junik, Deçan, Prizren, Klinë, Lipjan dhe Fushë Kosovë;
- Raportimi i kryetarit para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës konform neni 58 shkronja (j) të Ligjit, Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të kryetarit të komunës: Gllogoc, Prishtinë, Novobërdë dhe Klokot;
- Emërimi i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete ashtu si është përcaktuar në nenin 61 të LVL-së nga Komuna: Prizrenit, Klokot, Fushë Kosovës dhe Novobërdës;
- Të funksionalizohet sistemi i teleprezencës në komunën e Mamushës, Junikut, Graçanicës dhe Klokot, konform Udhëzimit Administrativ Nr.2012/01 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave Përmes Pajisjeve të Teknologjisë Informatike “TELEPREZENCAVE”;
- Komunat ti themelojnë komitetet konsultative më qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, konform nenit 73 të LVL-së;
- Komunat të respektojnë parimet, kriteret dhe procedurat ligjore për hartimin dhe miratimin të akteve juridike nënligjore.